

Republika e Shqiperise
Gjykata Administrative e Shkalles se Pare
Korçe

K O R Ç E

Nr 352 rregjistri themeltar.
Date rregjistrimi 04.03.2015

Nr 217 Vendimi
Date 04.05.2015.

V E N D I M
“Ne emer te Republikes”

Gjykata Administrative e shkalles se pare Korçe e perbere prej:

Kryetare e seances gjyqesore - **ETLEVA GJAMO**

asistuar nga sekretare e seances gjyqesore Viola Palla , ne Gjykate, ne date 04.05.2015 , ora 11 30 mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura çeshtjen administrative me nr 352 rregjistri themeltar , date 04.05.2015 rregjistrimi qe i perket:

PADITES: “**Idajet Shkulaku**” person fizik , ne adresen Komuna Dardhas, Qafe Plloçe, Pogradec perfaqesuar me prokure te posaçme nr 382 rep, 200 kol date 04.03.2015 nga Ruzhdi Shkullaku.

E PADITUR: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçe, perfaqesuar me autorizim nga juristja Mirela Veriga.

OBJEKTI: Shfuqizimi dhe anullimi teresisht i “Njoftim vleresimit” te nxjere nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe nr 156, date 15.01.2015, mare me poste ne daten 19.01.2015, i cili permбан gjobe mospajisje me kase fiskale ne shumen 100 000 leke.

Baza ligjore: Ligji nr 49/2012, nenet 7/b, 11/1, 15/a), 17/a, 18/4, Kodi i Procedurave Administrative, nenet 18/b, 123, Kodi i Procedures Civile nenet 41, 42, 324, 327, 328, ligji 9920 date 19.05.2008 i ndryshuar, neni 109 .

Ne perfundim te gjykimit te zhvilluar ne prani te paditesit, perfaqesuesit te tij me prokure dhe te perfaqesueses me autorizim te pales se paditur, perfaqesuesit i paditesit kerkoi pranimin e padise, perfaqesuesja e pales se paditur kerkoi rrezimin e padise.

Gjykata pasi shqyrtoi aktet dhe çeshtjen ne teresi

V E R E N

Nga ate dhenat e Ekstraktit historik te QKR rezulton se paditesi Idajet Shkulaku eshte rregjistruar si person fizik me objekt te veprimtarise “Bar Restorant”.

Ne daten 16.12.2014 nga Inspektoret e verifikimit ne teren te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe eshte ushtruar kontroll ne vendin e ushtrimit te veprimtarise ku ka rezultuar se ... *subjekti nuk e ka kasen fiskale pasi e ka çuar per*

riparim. Subjekti ka nje distributor gazi pa kase te cilin deklarone se e perdor per nevojat e tij ne punes ne biznes. Subjekti zhvillon aktivitet ne pronen e vet

Mbi konstatimet e mesiperme, me "Procesverbalin date 16.12.2014" subjekti fizik denohet me gjobe ne shumen 100 000 leke, ne shkelje te nenit 122, pika 1, germa a) e ligjit 9920, date 19.05.2008, per shkak se subjekti nuk eshte i pajisur me kase fiskale.

Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe, ne daten 15.01.2015 ka nxjere "Njoftim vleresimin per detyrimet tatimore" nr 156 Prot, per pagesen e gjobes ne shumen 100 000 leke, e cila i eshte njoftuar subjektit.

Meqenese subjekti nuk ka qene dakord me detyrimin e vendosur, e ka ankimuar "Njoftim-vleresimin" ne Drejtorine e Apelimit Tatimor Tirane, e cila me vendim nr 2674/1 Prot date 13.02.2015, ka lene ne fuqi njoftim vleresimin per detyrimet tatimore.

Pas rrezimit te ankimit, paditesi brenda afatit ligjor 30 ditor nga marja dijene e vendimit te Drejtorise se Apelimit Tatimor, pra pas ezaurimit te ankimit administrativ siç percaktohet ne nenin 109.2 te ligjit nr 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i eshte drejtuar Gjykates me kerkese padi, me anen e te ciles kerkon "Shfuqizimin teresisht aktit administrativ "Akt-Njoftim vleresimi tatimor" 156 prot date 15.01.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe, si akt relativisht i pavlefshem".

Lidhur me shkaqet ligjore te shfuqizimit te aktit administrativ, njoftim vleresimit per detyrimet tatimore, perfaqesuesi i paditesit prashtroi se ky akt eshte hartuar ne zbatim jo korekt te ligjit "Per procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" pasi paditesi nuk ka shkelur asnje dispozite ligjore qe te penalizohet me gjobe.

Sipas paditesit neni 122, pika 1, germa a) e ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" nenkupton faktin se pajisja fiskale duhet te instalohet aty ka ka shitje mallrash apo sherbimesh nga tregetaret ose shoqerite tregetare me vlere nen 150 000 leke nderkohe qe paditesi nuk ka shitur asnjehere gaz te lenget nga bombola e gazit dhe nje fakt i tille nuk eshte konstatuar as nga inspektoret. Vendi ku eshte vendosur bombola e gazit me kapacitet 2000 litra eshte ne ambientet e brendshme te subjektit, jo ne ambient reklamimi dhe e paeksponuar per shitjen e gazit. Per shkak te parametrave te saj bombola eshte e pajisur me pistolette per mbushjen e bombolave te gazit deri ne 25 litra te cilat lidhen me soben e kuzhines qe perdoret per gatim te pakten nje here ne dite si dhe gazi perdoret edhe per ngrohjen e ambienteve ne dimer nga sobat e ngrohjes me gaz. Ne proceduren e zbatuar nga Inspektoret e DRT Korçe ka disa shkelje ligjore pasi neni 122 i ligjit 9920 date 19.05.2008 ka pesuar ndryshime me ligjin nr 164/2014 i cili ka hyre ne fuqi ne date 01.01.2015 dhe favorizon subjektin. Inspektoeret e DRT Korçe ne momentin e kontrollit nuk kane patur Urdherin e kontrollit nr 6079 date 16.12.2014, ne shkelje te nenit 81 te ligjit 9920 date 19.05.2008 dhe Udhezimit nr 24 date 02.09.2008 ne zbatim te tij, ku percaktohet procedura qe ndiqet gjate nje kontrolli. Ne kushtet kur paditesi eshte i pajisur me kase fiskale per aktivitetin kryesor dhe ne mungese te saj ka perdorur deftesat tatimore nuk mund ti kerkohet instalimi i nje pajisje te dyte fiskale per nje proces pune nga i cili nuk arketon leke por perben nje proces ndihmes per vazhdimin e aktivitetit. Ne kushtet kur paditesi i kerkohet instalimi i nje pajisje te dyte fiskale per here e pare duhet i lihej nje afat kohor 10 ditor nga data e mbajtjes se akt konstatimit. Nese paditesi tregetonte gas Inspektoret e DRT

Korçe duhet te gjykonin ne baze te ligjit nr 8450 date 24.02.1999 “Per perpunimin, tregetimin dhe transportimin e naftes, te gazit dhe nenprodukteve te tyre” ku parashikohet bashkepunimi me organe te tjera dhe masat administrative fillojne nga 5000 000 leke gjobe deri ne sekuestrimin dhe konfiskimin e aktivitetit e persa me siper pretendimi i pales se paditur per pajisjen e bomboles me kase fiskale eshte vetem nje veprim i pajustificuar i inspektoreve dhe gjoba eshte e pabazuar ne ligj.

Perfaqesuesja e pales se paditur gjate gjykimit dhe ne perfundim te tij prapesoi se baze te nenit 80.3 te ligjit 9920 date 19.05.2008 administrata tatimore ushtron kontrole te befasishme ne vendin e ushtrimit te aktivitetit me qellim zbulimin ne kohe te shkeljeve , pa njoftim paraprak por vetem nepermjet prezantimit te inspektoreve dhe urdherit ditor te punes leshuar nga Drejtori i DRT per kontroll ne vend.Ne nenin 55 te ligjit 9920 date 19.05.2008 parashikohet detyrimi i tatimpaguesve per te instaluar dhe perdorur pajisjen fiskale per qarkullimin e mallrave dhe sherbimeve per te cilat pagesat kryhen me para ne dore.Akti i konstatimit eshte mbajtur ne zbatim korekt te ligjit material dhe ligjit 10 279 date 20.05.2010 “Per kundravajtjet administrative” .

Duke referuar ne ligjin nr 8450 date 24.02.1999 paditesi pranon faktin se nuk ka license per tregetim gazi , pra ushtron nje aktivitet te paligjshem rrethane e cila e rendon situaten e tij nderkohe qe nuk verteton qe distributorin e perdor vetem per nevoja te tij.Konstatimi i inspektoreve se distributori gjendej ne nje ambient te hapur dhe rregjistronte ne castin kur ngrihej pistoleta eshte nje fakt i pakontestueshem dhe ne kushtet kur paditesi me mosveprim ka konsumuar elementet e kundravajtjes se parashikuar nga neni 112, pika 1, germa a) e ligjit 9920 date 19.05.2008, padia e tij duhet te rrezohet si e pabazuar ne prova dhe ne ligj.

Gjykata pasi shqyrtoi pretendimet e paditesit, prapesimet e pales se paditur dhe provat e sjella prrej tyre, çmon se padia e paditesit eshte e pabazuar ne ligj dhe ne prova dhe si e tille duhet te rrezohet.

Per efekt te shqyrtimit te ligjshmerise se aktit qe kontestohet, pra ligjshmerise se denimit me gjobe, ne formen e “Njoftim vleresimit tatimor”, gjykata do ti referohet te dhenave te aktit te konstatimit date 16.12.2014 , motivimit te shkeljes sipas procesverbalit te denimit me gjobe si dhe dispozitave ligjore qe pretendohet se jane cenuar nga subjekti tatimpagues(paditesi).

Po keshtu do te referohet edhe ne ligjin “Per kundravajtjet administrative” nr 10 279, date 20.05.2010, i cili zbatohet per te gjitha vendimet e organeve te administrates publike qe parashikojne denime administrative e qe krijojne pasoja juridike ne raste individuale.

Ne zbatim te nenit 80.3.c) te Udhhezimit nr 24 date 02.09.2008 “Per procedurat tatimore” njihet e drejta e inspektoreve tatimore qe te kryejne verifikime ne vend, pa njoftim paraprak te cilat synojne zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje ...me perdorimin e pajisjeve fiskale.

Shkeljet qe kane lidhje me perdorimin e pajisjeve fiskale gjejne rregullim te shprehur ne ligjin nr 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise” ku ne nenin 122 parashikohen kundravajtjet administrative per perdorimin e pajisjeve fiskale per leshimin e kuponave dhe biletave, ndersa ne nenin 123 parashikohen denimet per shoqerite e autorizuar dhe te paautorizuara.

Po ti referohemi “Aktit te konstatimit” date 16.12.2014 nder te tjera evidentohet fakti se... subjekti Idajet Shkulaku ka nje distributor pa kase te cilin

deklararon se e perdor per nevojat e tij te punes ne biznes".Persa me siper eshte mara masa e denimit me gjobe per mospajisje me kase fiskale.

Pala paditese kundershkon denimin me gjobe me aresyetimin se nuk ka kryer asnje shkelje ligjore pasi nuk tregeton gaz te lengshem dhe nuk duhet te penalizohet me gjobe dhe as te detyrohet per te instaluar nje pajisje te dyte fiskele.

Por gjykata vlereson se njoftim vleresimi per detyrimet tatimore ka dale ne baze te ligjit pasi eshte konstatuar kryerja e kundravajtjes administrative te parashikuar ne neni 122, pika 1, germa a), nendarja i) e ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" ku eshte parashikuar se:

Tatimpaguesi person juridik ose fizik, tregetar, denohet ne rast se:

- a) Nuk instalon pajisjen fiskale per rregjistrimin e pagesave me para ne dore.
- i) Heren e pare te konstatimit te mosinstalimit te pajisjes fiskale per te cilen eshte percaktuar nje afat vendosje deri ne 10 dite pune, me gjobe ne masen 100 000 leke.

Ne veshtrim te nenit 55 te ligjit 9920 date 19.05.2008 percaktohet se *"Tatimpaguesit qe kryejne qarkullimin e mallrave dhe te sherbimeve per te cilat pagesat nuk kryhen nepermjet bankes jane te detyruar te fusin dhe perdorin sistemin fiskal nepermjet perdorimit te pajisjes fiskale per rregjistrimin e pagesave me para ne dore dhe per leshimin ne mneyre te detyrueshme te kuponit tatimor.*

Paditesi ngre pretendimin se inspektorët e kontrollit nuk e kane gjetur duke tregetuar gaz te lengshem por gjykata vlereson se penalizimi i tatimpaguesit nuk eshte bere per mosleshim te kuponit tatimor per qarkullim te realizuar te mallrave apo sherbimeve pasi kjo lloj kundravajtje parashikohet ne germen b) te pikes 1 te nenit 122 te ligjit 9920 date 19.05.2008.

Sipas ligjit "Per kundravajtjet administrative" neni 13, germa b) kemi te bejme me mbajtje te nje procesverbali ne rastet kur konstatimi i shkeljes lidhet me vendin ku ndodh ngjarja(pra ku kryhet veprimi ne shkelje te ligjit) dhe procesverbali i konstatimit eshte akti mbi bazen e te cilit gjykohet nese eshte kryer ose jo kundravajtje administrative tatimore.

Referuar sa me siper, ne kushtet kur provohet shkelja konkrete e dispozites ligjore te cituar ne procesverbalin e denimit me gjobe, konkludohet per kundravajtje administrative dhe rrjedhimisht me te drejte eshte vendosur dhe penalizimi i subjektit.

Sipas nenit 4 te ligjit "Per kundravajtjet administrative", qe te linde baza e pergjegjesise administrative te nje subjekti duhet qe nga ana e tij te jete kryer shkelje me faj e dispozitave ligjore ose nenligjore, e kryer me veprim ose mosveprim dhe per te cilen ligji te parashikojte denim administrativ.Referuar elementeve te kesaj dispozite, cmohet se ato motivohen ne aktet e pales se paditur ne rastin objekt gjykimi, prandaj edhe penalizimi me gjobe ne shumen 100 000 leke vleresohet ne perputhje te plote me ligjin, bazuar ne gjendjen faktike te konstatuar ,provuar me prova shkresore dhe nuk permban asnje element tjeter qe do ta bente njoftim vleresimin per detyrimet tatimore nje akt relativisht te pavlefshem ne kuptim te nenit 118 te Kodit te Procedurave Adminsitative.

Kjo per faktin se ne momentin e nxjerjes se ketij akti, kane ekzistuar pikerisht rrethanat qe vete dispozitat ligjore te ligjit "Per procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" kerkojne si kusht per aplikimin e denimit me gjobe, prandaj dhe padia e paditesit duhet te rrezohet si e pabazuar ne prova dhe ne ligj.

Persa i takon pretendimit te paditesit se ne momentin e nxjerjes se njoftim vleresimit per detyrimet tatimore neni 122 i ligjit 9920 date 19.05.2008 ka pesuar ndryshime qe e favorizojne paditesin pasi parashikojne nje mase denimi me gjobe prrej 50 000 leke nuk cenon ligjshmerine e vendimarrjes se pales sepaditur pasi denimi administrativ i referohet ligjit te zbatueshem ne momentin e konstatimit te kundravajtjes, pra neni 122 i ligjit para ndryshimeve te bera me ligjin nr 164/2014, i cili ka hyre ne fuqi ne daten 01.01.2015 nderkohe qe kundravajtja administrative eshte konstatuar ne daten 16.12.2014. Nga ana tjeter pretendimi i paditesit se jane cenuar procedurat e kontrollit eshte i pabazuar ne ligj pasi ne rastin konkret nuk ndodhemi para nje kontrolli tatimor ne kuptim te nenit 80 te ligjit 9920 date 19.05.2008 qe subjektit ti dergohet njoftimi per kontroll, por ndodhemi para kontrolleve te befasishme te parashikuara ne nenin 80.3.c te Udhhezimit nr 24 date 02.09.2008 qe lidhet me verifikimet ne vend me qellim zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje me perdorimin e pajisjeve fiskale dhe inspektoret kane qene te pajisur me Urdherin e punes cituar edhe ne aktin e konstatimit.

Ne veshtrim te nenit 45 germa a) te ligjit 49/2012 ky vendim eshte i paankimueshem pasi sipas kesaj dispozite.... *nuk lejohet ankim ndaj vendimeve perfundimtare te gjykates administrative per padi me objekt kundershhtimin e denimit per kryerjen e kundravajtjeve administrative me vlere me te vogel se 20-fishi i pages minimale ne shkalle vendi.* Ne baze te VKM nr. 573, datë 3.7.2013, "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", duke filluar nga muaji Korrik 2013 e ne vazhdim, paga bazë minimale mujore, për punonjësit në shkallë vendi, eshte 22.000 (njezet e dy mije) leke.

Persa i takon shpenzimeve gjyqesore te takses mbi aktet ne shumen 3 000 leke dhe ato te perfaqesimit me avokat ne shumen 3 000 leke te parapaguara nga paditesi, konform nenit 106/1 te K.Pr.C mbeten ne ngarkim te tij meqenese çmohet rrezimi i padise.

PER KETO ARESYE

Bazuar ne nenet 41-42, 45/b te ligjit 49/2012

V E N D O S A

1.Rezimin e padise se paditesit "Idajet Shkulaku" person fizik, e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe , me objekt "*Shfuqizimi dhe anullimi teresisht i "Njoftim vleresimit" te nxjere nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe nr 156, date 15.01.2015, mare me poste ne daten 19.01.2015, i cili permban gjobe mospajisje me kase fiskale ne shumen 100 000 leke*" si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.

2.Shpenzimet gjyqesore ne shumen 3 000 leke, te paguara nga pala paditese, mbeten ne ngarkim te saj.

3.Kunder ketij vendimi nuk lejohet ankim.

U shpall ne Korçe date 04.05.2015

Sekretare
Viola Palla

G J Y Q T A R E
ETLEVA GJAMO